


Ljiljana Lazareviq

Jeta e përditshme në Mbretërinë S.K.S. 1918-1941





Pyetja kyçe

Jeta e përditshme – zgjedhje apo barë e traditës?

Tema

Moduli ka të bëjë me natyrën komplekse dhe dallimet në jetën e përditshme në shtetin e ri. Nxënësit duhet të krijojnë pasqyrë më të gjerë për atë si ishte jeta në vendin me dallime të mëdha dhe kontroversa, në nivel regjional, nacional...

Periudha është 1918-1941

Është relevante për shkak të nevojës për të përmirësuar nivelin e tolerancës dhe vetëdijesimit në regjion (për të qenë të vetëdijshëm për dallimet dhe sa thellë janë të rrënjosura disa çështje, por gjithashtu sa të ngjashme janë disa probleme në pjesë të ndryshme të regjionit), dhe është kontroverse në kuptim të asaj se sa ishte e ndryshuar jeta në një periudhë relativisht të shkurtër (në fillim të periudhës, në disa zona njerëzit flinin me bagëtinë, gratë nuk kishin të drejta... dhe fëmijët mund të krahasojnë se si dukej jeta krahasuar me të sotmen). Përveç kësaj, dallimet të tilla të larta regjionale për nga cilësia e jetës së përditshme janë kontroverse dhe të ndjeshme për nga vetja, dhe çështja e urbanizimit në Ballkan është kontroverse gjithashtu.

Rezultatet e mësimi:

- Nxënësit do të jenë në gjendje të kuptojnë ndryshimin dhe vazhdimësinë e fenomenit social, dhe të vërejnë dallimet dhe ngjashmëritë mes së kaluarës dhe të tashmes në këtë kuptim
- Nxënësit do të jenë në gjendje ta kuptojnë natyrën komplekse të ndërveprimit mes tradicionales dhe modernes në shoqërinë jugosllave mes dy luftërave
- Nxënësit do të zhvillojnë shkathtësi për ndjeshmëri
- Nxënësit do të mësojnë për specifikën e cilësisë së jetës së përditshme gjatë periudhës mes luftërave (dallime mes qytetit dhe periferisë, argëtimit dhe veshjes).

Qëllimet

- Mirëkuptimi kritik i natyrës komplekse të së kaluarës
- Mirëkuptimi i identitetit nacional
- Përkrahja e nxënësve për të kuptuar vetë
- Respekti i ndërsjellë, paqja, stabiliteti dhe demokracia
- Vetëdijesimi historik

Udhëzime për mësimdhënësin

Hapi 1:

Hyrje (kontekstualizim) – mësimdhënësi do ta lexojë hyrjen (Konkretizimin)/do ta sqarojë situatën e përgjithshme në vend të mbështetur në hyrjen vijuese

Hapi 2:

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në dy grupe:

- 1) **Grupi i parë** i merr burimet – Fshati / Qyteti
- 2) **Grupi i dytë** i merr burimet – Tradicionale / Moderne

Ai/ajo jep udhëzime: grupi do t'i analizojë burimet, të udhëhequra nga çështjet që i pasojnë burimet, dhe kur të mbarojnë, ata do t'i bashkëngjiten aktivitetit.

Hapi 3:

Mësimdhënësi i pyet nxënësit që ta plotësojnë tabelën vijuese, për pozitën e gruas, nga elementet që ata i gjejnë te burimet:



90
minuta

Hapi 1

Hyrje:

Mbretëria e S.K.S. është formuar pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, mbështetur në idenë e rrënjëve të përbashkëta të sllavëve të jugut. Shteti i ri u krijua me bashkëngjytjen e regjioneve të cilët kishin trashëgimi të ndryshme kulturore. Dallimet ishin të mëdha në çdo drejtim: politik, kulturor, nacional, ekonomik... Ajo ishte kryesisht vend bujqësor me nivel të lartë të popullsisë fshatare, jeta e të cilëve mbështetej në traditat dhe shprehitë tradicionale. Procesi i industrializimit kryesisht e përshkoi tërë regjionin. Pjesët perëndimore dhe veriore të shteteve (të cilat dikur ishin pjesë e perandorisë austro-hungareze) ishin të zhvilluara, ndërsa pjesët jugore të vendit (të cilat ishin nën Perandorinë Osmane) ngecnin. Të gjithë këta faktorë, në kombinim me dallimet politike dhe nacionale, krijuan shumë probleme në funksionimin e shtetit të porsakrijuar.

Burimi 1

Shtetet dhe territoret që u bashkuan më 1918



Repe Bozo, Sodobna zgodovina za 4.letnik gimnazij, str.82

Burimi 2


Tabela me numrin e popullsisë dhe të qyteteve

Lj. Dimic, Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije, str.36

	1921	1931
Popullsia (në mijëra)	Numri i qyteteve	Numri i qyteteve
10-20	30	124
20-50	11	25
50-100	3	4
> 100	2	3

Burimi 3

Zhvillimi industrial sipas regjioneve



Repe Bozo, Sodobna zgodovina za 4.letnik gimnazij. Ljubljana: Modrijan 2007, str. 97

Burimi 4

Profesionet e popullsisë në Mbretëri

Ljubodrag Dimić, Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918'1941, II, str.35

Llojet e profesioneve	1921	1931
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	78.87%	76.58%
Industria dhe zejet	9.91%	11.00%
Tregtia, kreditë,	4.35%	4.85%
Shërbimet publike	3.80%	4.08%
Profesionet tjera	3.07%	3.49%

Burimi 5

Analfabetizmi sipas provincave

			Lexojnë dhe shkruajnë			Lexojnë	Analfabetë
Provincia e:	M	F	Gjithsejtë	M	F	Gjithsejtë	Gjithsejtë
Dravës	94,13%	92,41%	93,23%	1,80%	1,23%	1,23%	5,54%
Drinës	56,37%	18,56%	37,49%	0,32%	0,42%	0,40%	62,11%
Dunavës	82,03%	59,67%	70,52%	0,45%	0,77%	0,61%	28,87%
Moravës	60,76%	16,01%	37,70%	0,41%	0,27%	0,34%	61,96%
Primoriës	55,48%	29,37%	42,08%	0,41%	0,51%	0,46%	57,46%
Savës	80,06%	63,78%	71,60%	0,37%	1,07%	0,73%	27,67%
Savës	80,06%	63,78%	71,60%	0,37%	1,07%	0,73%	27,67%
Vardarit	43,89%	14,32%	28,84%	0,41%	0,18%	0,30%	70,86%
Vrbasit	39,73%	13,95%	27,09%	0,38%	0,24%	0,31%	72,60%
Zetës	50,69%	16,69%	33,50%	0,51%	0,41%	0,46%	66,04%
Beogradit	92,66%	84%	88,69%	0,24%	0,68%	0,44%	10,87%
Gjithsejtë	67,31%	42,90%	53,83%				44,51%

Ljubodrag Dimić, Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918'1941, II, str.192

Burimi 1

Qytetet dhe fshatrat

...Mbi ¾ e popullsisë në Mbretëri jetonin nga bujqësia, d.m.th. rreth 80% e popullsisë aktive fitimet e saja i nxirrte nga bujqësia... Edhe pse në periudhën 1921-1931, sipas disa të dhënave, drejt qyteteve u nisë rreth një milion banorë, gjë që ndikoi të shtohet numri i qyteteve të vogla me ekonomi të zhvilluar dobët dhe pa standard urban jetësor... Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vitit 1925 kishte 24.255 fshatra dhe 4.595 fshatra të vegjël, gjithsejtë 96% e të gjitha vendbanimeve, ndërsa të gjitha vendbanimet tjera ishin 1.265 (qytete, qyteza, vende tregtie, paralagje, banja, vend ferme, manastire). Sipas të dhënave të njëjta nëpër qytezat dhe qytetet jetonte rreth 15,8% e popullsisë.

Lj. Dimic, *Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije, 1918-1941*, str.35

Burimi 2

Tuberkulozi

„Tuberkulozi shfaqej si sëmundje e shpeshtë, kronike, popullore, sociale. Në literaturën mjekësore ajo bën pjesë në grupin e të ashtuquajturave “misione të rrezikshme të popullit”. Nga tuberkulozi vdiste rreth 14% e numrit të të vdekurve. Edhe në këtë drejtim ekzistonte një pabarazi e shprehur, kështu që në banovinën e Savës, çdo i pesti vdiste nga tuberkulozi, ndërsa në Beograd kjo ndodhte te çdo i pesëdhjeti. Pabarazi ekzistonte edhe mes fshatit dhe qytetit. Tuberkulozi në fillim shfaqej si sëmundje qyteti – sëmundje e banesave të këqija. Pranimi i shpejtë i shprehive higjienike në mënyrë vendimtare kontribuoi për atë që vdekshmëria nga tuberkulozi të bie në qytet dy herë më shpejtë sesa në fshat, i cili vështirë çlirohej nga prapambetja kulturore dhe shëndetësore. Vetëm në banovinën e Dravës, gjatë gjithë periudhës së mes luftërave, vdekshmëria nga tuberkulozi ishte më e lartë në fshat sesa në qytet...”

Lj. Dimic *Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918-1941*, str.66/67

Burimi 3

Zbavitja në Beograd

Qytetarët e Beogradi kishin disa argëtime në qytet. Për shembull, aty u hapën kinematë e para. Zgjidhje interesante ishte ajo te “Partizani” në rrugën Terazija. Meqenëse aty improvizohen salla e kinemasë në një oborr të gjatë dhe të ngushtë, pëlhura vendosje e varur në mes të hapësirës, kështu që shihej nga të dyja anët, ndërsa që të ishte e qartë pamja, pëlhura lagej me spërkatëse. Shikuesit shihnin nga tavolinat e kafenesë, hanin dhe pinin (nga ana e përparme kishte vetëm kafene, ndërsa në anën e prapme darkohej), muzikën e bënte një piano, ndërsa më vonë një orkestër e vogël prej dy-tre instrumenteve. Në rast të pamjeve tragjike luhej ndonjë muzikë serioze, ndërsa në raste qesharake diçka e shpejtë dhe e hareshme. Filmat, kuptohet, ishin pa zë...

“Detinjstvo u proslosti”, Bgd 2001, iz: Aleksandar Deroko, “A ondak je letijo jeroplan nad Beogradom”

Burimi 4

Ekipi i filmimit në sheshin Terazija (Beograd)



<https://www.facebook.com/Crno.beli.Beograd>, (19.5.2012.)

Burimi 5

Ushqimi (Dieta)

“Ushqimi i fshatit dhe qytetit, në vitet e tridhjeta, filloi të dallohet. Në ushqimin e qytezës filloi të mbisundojnë prodhimet me prejardhje shtazore (rritet përdorimit i mishit dhe qumështit), ndërsa ushqimi me prejardhje bimërore edhe më tej mbizotëronte në ushqimin e fshatit. Në ushqimin e popullsisë së qytetit vërehej dallim i parëndësishëm mes ushqimit dimëror dhe veror, ndërsa në fshat edhe më tej mbizotëronin dy lloje themelore të ushqimit – veror dhe dimëror... Krahas bukës, grosha dhe patatja janë ushqime themelore...”

Lj. Dimic *Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918-1941*, I, str.62

Izvor 6

Ushqimi (Dieta) II

Ushqimi në fshat kryesisht përbëhej nga buka e theknit, qepa, djathi, sallata. Kripa përdorej pak sepse, sipas fjalëve të fshatarëve, ishte e shtrenjtë. Mjaft rrallë në ushqimin e gatuar shfrytëzohej gjalpi ose vaji – populli mban kreshmë mjaft. Kam llogaritur se gjatë një viti ka 260 ditë kreshmë. Priftërinjtë e fshatit nuk i lejojnë popullit që të shfrytëzojë vaj ose peshk, ndërsa vet gjatë tërës tërës gjuajnë peshk në lumin Crna dhe e përgatisin. Përdorin rekrutët shpesh nuk peshojnë as 40 kilogramë, priftërinjtë e tyre kalojnë 100 dhe 120 kilogramë.

Д

2 .20,

Izvor 7

Veshja

“Thuhet se dikush është i veshur mirë nëse i ka teshat e reja apo të ruajtura mirë, të shtrenjta dhe të pastra. Ndërsa llogaritet se ai i cili kujdeset së tepërmi për teshat nuk është ose nuk do të bëhet zot shpie i mirë. Ai tepër kohë humb në veshje dhe shumë harxhon për veten. Derisa te djemtë që nuk janë të martuar ose vajzat që nuk janë të fejuara, mendohet që duhet që vishen sa më bukur dhe pastër. Sipas veshjes vlerësojnë si shtëpia e vajzës për gjendjen materiale të djaloshtit, ashtu edhe ana e djaloshtit për vajzën dhe shtëpinë e saj. Të rinjtë vishen mirë edhe gjatë vitit të parë të jetës martesore, së pari sepse janë ende të rinj dhe tjetra sepse kanë çka të veshin. Gradualisht vjetërsohen teshat e martesës, si e dhëndrit, ashtu edhe e nuses. Ndërsa nuk blihet asgjë e re. Sa u përket fëmijëve, ata duhet të vishen pastër kur shkojnë në kishë të luten dhe në përgjithësi kur ka ndonjë festë dhe kur shkojnë mysafirë. Përndryshe, “fëmijët janë fëmijë dhe asnjëherë nuk mund të jenë të pastër”.

Aleksandar Petrović, Rakovica. *Socijalno - higijenski problemi*, Beograd 1939, 148

Izvor 8

Veshja II

“Mënyra e veshjes, si edhe jeta në tërësi, i është nënshtruar normave mbisunduese të sjelljes në një mjedis të caktuar, rregullave të saja kolektive, idealeve të miratuara estetike të bashkësisë, mundësive ekonomike dhe teknike. Mënyra e veshjes është njëri nga treguesit më të mirë të ndryshimeve shoqërore të cilat e kanë përfshirë fshatin jugosllav. Në Mbretërinë Jugosllave haseshin më shumë lloje të veshjeve popullore (alpine, panonike, moravike, maqedonase, adriatike, dinarike), prej të cilave secila i mbante karakteristikat themelore të brezave kulturorë nga të cilët u krijuan... Përdorimi në masë i prodhimeve industriale të cilat e ndryshonin jetën... veshjet popullore padyshim që u pakësuan. Ky proces ishte më i shpejtë në banovinën e Dravës, zonat industriale të Savës dhe Dunavës, në qytetet e mëdha. Sipas disa të dhënave, në vitin 1918 veshje mbante rreth 60% e banorëve të Mbretërisë. Nga fshati silloven ajo thuajse tërësisht u hoq... Në anën tjetër, në zonat Dinarike, në jug dhe juglindje të Serbisë, Maqedonisë, pëlhurat shtëpiake nga leshi, konopi, lini, lëkura, pambuku ishin në përdorim të përditshëm... Në ato zona veshjet popullore ishin në përdorim të përditshëm...”

Lj.Dimić, *Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije*, I, Bgd, 1994, str. 74

Izvor 9

Gruaja në fshat

“Nëna ime, Persa, kujdesej për dhjetë fëmijë, pesë të sajat dhe pesë të motrës. Tezja vdiq nga tuberkulozi, ndërsa buri i saj u vra në luftë. Kështu që kujdesin për fëmijët e tyre e mori nëna ime, e cila kishte kafene në fshatin në të cilin jetonim, Divçica, në paralarje të Valjevës. Ishte grua e fuqishme, e vendosur, e vlefshme dhe e aftë, ndërsa puna e saj kryesore ishte në kuzhinë; ishte gatuese e mrekullueshme – avokatët dhe njerëzit e famshëm nga Valjeva çdo ditë kalonin nga 10 km që të vinin në drekë te Persa. Në të njëjtën kohë kujdesej edhe për financat, furnizimet, shtëpinë dhe fëmijët, ndërsa ne, fëmijët, duhej t'i respektojmë më të moshuarit dhe ndihmojmë rreth furnizimeve. Nëna kishte natyrë të butë por të vendosur, asnjëherë nuk e ngrinte tonin, por prej nesh pritej dëgjueshmëri absolute. Babai ishte njeri i qetë, i tërhequr, i paeksponuar, por kujdesi dhe përgjegjësi në lidhje me të gjitha i ishte lëshuar nënës. Krahas të gjitha obligimeve të cilat ishin të pandërprera dhe të mëdha, asnjëherë nuk e kam dëgjuar t'i ankohet dikujt ose që e ka të vështirë...”

Kujtimet e Millosh Nedoviqit, i lindur në vitin 1930.

Pyetje për të punuar me burimet:

1. Deri në cilën masë dallonin ushqimi në fshat dhe qytet?
2. Çka kishte mundësi të ofrojë fshati si argëtim?
3. Çfarë lloj argëtimi ekzistonte në qytet?
4. Si e përjetonin njerëzit modën? A ishte çështje e shijes personale, apo shprehi që buronte nga tradita?
5. Cili është ndikimi i modës në jetën tuaj? A mendoni se ishte njëjtë edhe në të kaluarën?

Burimi 1

Fshati në qytet

“Pamjet e figurave të fshatarëve të papastër dhe të veshur dosido që i shohim sot nëpër qytezat më të mëdha, por edhe nëpër fshatra, janë dukuri kalimtare, e shkaktuar nga proletarizimi i përsheptuar dhe rënia ekonomike e një pjese të fshatarësisë, e diçka nga hutimi i tij shoqëror në valën e modernizimit para së cilit fshatari me kulturën e tij tradicionale-patriarkale ndihet i dobët, i prapambetur dhe para së gjithash i pafuqishëm. Ky devijim i jashtëm është shprehje e sfidës së tij të brendshme, e jo vetëm materiale-ekonomike. Ngado që fshatari mbahet fort dhe me baraspeshë në bazën ekonomike të jetës së tij, ai këtë gjendjet të tij e shpreh edhe me veshje dhe stoli”.

V.Dvornikovic, Bgd, 1990,463.

Burimi 3

“Modernizimi”

“Sot, njëqind vjet më vonë, Beogradi nuk gëlltit dhe nuk tretë më: është gëlltitur nga Mesdheu, Ballkani, Budapesti, por më së shumti nga të ardhurit e fshatit të të gjitha racave, gjuhëve dhe feve rreth tij, të cilët – të shkukur gjer në rrënjë – nuk jetojnë as nën kulmin e tyre as në mëhallën e tyre, por në rrugë, në kafene, kinema, “bar”, “bife”, në “qebaptore”, në shitore me “prodhime nga Uzhica”, në pafund kafene me skarë para derës ose kokën e dërrit në dritare ose në lokalet e ashtuquajtura “arti i Bohemisë” njërës ndër industritë më banale në atë tollovi të qytezës. Në Beograd, i cili tani është tre herë më i madh, ka tridhjetë herë më shumë gjëra të tilla se në periudhën e paraluftës, dhe pikërisht tani, pas ndërtimit të rrokaqiejve dhe shitoreve të begata parisiane, Beogradi është bërë qytezë e qebapëve dhe këngëtareve të kafeneve”.

М. Г , И С , Б
1939, 18.

Burimi 5

Vlerat tradicionale

“Besnik ndaj traditave të vjetra të serbëve, gjatë netëve të gjata të dimrit banorët e Idvorcit i mbanin bisedat e tyre të gjata. Si djalosh, unë isha në shumë prej tyre në shtëpinë e babait tim. Njerëzit e moshuar rrinin rreth kofortit të ngrohtë në karrigen e bërë nga materiali i njëjtë si koftori, zakonisht nga tullat e buta, të lyera me llaç dhe gëlqere. Njerëzit pinin duhan dhe bisedonin, ndërsa dukeshin si senatorë, rojtare të vetëquajtur të të gjitha urtësive në Idvor. Poshtë këmbëve të personave të moshuar qëndronin personat e rinj, ndërsa pranë secilit prej tyre qëndronte një kosh ku binte drithi nga kallinjtë e mëdhenj të misrit. Këtë e bënin tërë natën. Gratë plaka qëndronin në ulëset e vogla përgjatë murrit; ata tirnin lesh, linë ose konop, qepnin dhe arnonin. Si më i përkëdheluri i nënës, unë e kisha të lejuar të ulem pranë nënës sime dhe të dëgjoj fjalët e urta dhe imagjinatat nga goja e pleqve, ndërsa ndonjëherë edhe nga goja e mesoburrave ose të rinjve, nëse ua lejonin këtë pleqë. Kohë pas kohe, gratë këndonin nga ndonjë këngë e cila kishte lidhje me ngjarjet e përmendura. Për shembull, kur dikush nga personat e moshuar mbaronte bisedën për Karagjorgjen dhe luftërat e tij kundër turqve, gratë do të këndonin këngë në të cilat lartësohet guximi i Karagjorgjes dhe vojdodës Hajduk Veljko, i cili me një grusht serbësh e mbrojti Negotinin nga ushtria e madhe turke e Mulan pashës. Kjo çetë e guximshme, siç e këndon kënga, ta kujton atë çetën e vogël të grekëve të vjetër në betejën e Termopileve”.

Mihailo Pupin, Autobiografija iz: Detinjstvo u proslosti, BGd 2001, str.13.

Burimi 2

Familja



Privatna kolekcija porodice Mitrovic

Burimi 4

Amorali nga Shtinjan (afër Pullës)

Dikur dhe sot

“Siç është e njohur në tërë Istrën, dukur Shtinjan ishte krenari e tërë gadishullit. Rinia jonë qëndronte çdoherë në nivel shumë të lartë të moralit dhe nderit... Të gjithëve u linte mbresa fshati ynë dhe rinia jonë. Sot edhe te ne ndryshuan rrethanat tërësisht. Të rinjtë tanë pas terrorit të paparë shkuan përtej kufirit, ndërsa të tjerët në ushtri... Këtu ka disa vajza të këqija të cilat assesi nuk mundën të jetojnë pa puthjet e djelmoshave italianë. Këta vajza si të çmendura vraponin në Pullë dhe i thërrisnin marinarët italianë në Shtinjan. Kuptohet, marinarët si njerëz të rinj menjëherë u përgjigjeshin ftesave të tilla dhe organizonin vallëzime këtu... Është momenti i fundit që prindërit pak më mirë të kujdesen për vajzat e tyre, sepse përndryshe do të jetë vonë. Shtinjanë, Shtinjanë, ku shkoni?”

Novine Istarska rijec, 1923

Burimi 6
„Mika Mish (Miu Miki)”



“Miu Miki – Gëzuar krishtlindjet”
Sqarimi i fotografisë: Në fotografi shihen Miki dhe Mini (heronj të fëmijëve nga autori i famshëm amerikan i komikëve Walt Disney) si pjekin thi për krishtlindje, që është ngjarje tradicionale serbe. E tërë skena është shoqëruar me përshëndetjen serbe të krishtlindjeve “Hristos se rodi” që është edhe titulli i ballinës.

Faqja e parë, nr. II, 1937

Burimi 7
Gratë

“Por pa e marrë parasysh si ishte raporti në shtëpi, babai nuk udhëhiqte (Ndoshta kjo perandori shtëpiake ishte e vogël dhe e parëndësishme). Në fakt mbisundonin gratë: ata mbaheshin mend si sundimtare. Ky matriarkat në patriarkat (i tërë pushteti në emër të zotit të shtëpisë), i fortë dhe i patjetërsueshëm e i sigurt, me asgjë nuk u vu në dyshim, e.2 7.8976 cm BT 9

Burimi 8
Analfabetizmi

Numri i meshkujve dhe femrave që dinin shkrim e lexim sipas provincave në vitin 1931

	43,89%	14,32%
	50,69%	16,69%
	56,37%	18,56%
	60,76%	16,01%
	55,48%	29,73%
	82,03%	69,67%
	80,06%	63,78%
	92,66%	84,00%
	94,13%	92,41%

Lj. Dimic, Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918-1941, II, str.192

Burimi 10 Grua pilote II



<http://www.megaupload.com/?d=JOCR7Q9Q>
<http://www.megaupload.com/?d=JOCR7Q9Q>, (5.5.2011.)

Pyetje për punë grupore

1. Si e shihnin bashkë kohanikët jetën në qytet?
2. Cila sjellje e vajzave llogaritej “e ndershme”? A mendon se për djemtë vlente e njëjta gjë?
3. Si e sqaron dukurinë e gruas pilote në një shoqëri ku shumica e grave ishin analfabete?
4. A kishte mundësi çdo grua ta zgjedhë ardhmërinë e saj? A mundet sot? Argumentoje mendimin tënd.
5. Si i ndryshuan qytetet ndikimet nga fshati? A ishte procesi i kundërt?
6. A është Miki Maus hero tradicional? Cilët heronj tradicional i njeh? Cilët janë heronjtë e sotëm të fëmijëve?

Hapi 3

Mësimdhënësi i pyet nxënësit ta plotësojnë tabelën vijuese, për pozitën e gruas, me elementet që i hasin në burimet:

Urbane	Rurale	Tradicionale	Moderne